

Orari i konsultimeve të Zyrës së BE-së në Kosovë me shoqërinë civile në lidhje me ciklin e nënkomitetit të MSA-së 2016/2017

Një numër i nënkomiteteve të cilat shërbejnë si dialogje strukturore politike të fokusuar në zbatimin e MSA-së janë themeluar në kuadër të Marrëveshjes për Stabilizim Asociim (MSA). Ato raportojnë tek Komiteti i MSA-së dhe Këshilli i Stabilizim Asociimit. Në nënkomitete, BE-ja dhe Kosova do të diskutojnë mbi të gjitha fushat relevante për zbatimin e MSA-së. Si të tillë, Agjenda për Reforma Evropiane dhe Programi për Reforma Ekonomike të sapo lansuar janë angazhimet kryesore të cilat do të monitorohen dhe zbatimi të cilave do të diskutohet.

Zyra e BE-së në Kosovë përpiqet të sigurojë që shoqëria civile e Kosovës mund të ofrojë të dhëna dhe pikëpamje në mënyrë të pavarur, kuptimplote dhe thelbësore për të t'u futur në këto dialogje strukturore politike në mënyrë sa më të hapur dhe transparente. Ne synojmë t'i mbledhim të dhënat dhe pikëpamjet për nënkomitetet e MSA-së dhe takimet e grupeve speciale rreth dy javë para takimit zyrtar me autoritetet. Koha dhe lokacioni i saktë i konsultimeve me shoqërinë civile do të komunikohen me kohë. Zyra e BE-së poashtu do të përpiqet të sigurojë vlerësime nga organizatat e shoqërisë civile pasi që takimet e nënkomitetit dhe grupeve speciale të jenë mbajtur në përputhje me rregullat dhe procedurat e MSA-së.

Organizatat e shoqërisë civile të interesuara janë të ftuara t'i referohen orarit të mëposhtëm për planifikim paraprak të tyre. Ne kemi për qëllim të mbajmë diskutime me shoqërinë civile sa më konkrete dhe të orientuara drejt zgjidhjeve. Para konsultimeve, Zyra e BE-së do të japë informacione më specifike rreth temave që do të paraqiten gjatë diskutimit me autoritetet e Kosovës.

Shoqëria civile e interesuar ftohet që t'i dërgojë të dhënat e kontaktit (e-mail adresën dhe/ose detajet e stafit) tek Zyra e BE-së (felix.rathje@eeas.europa.eu), duke treguar se cilat nga fushat e cekura më poshtë janë me interes të veçantë, në mënyrë që të mbahen të informuar për zhvillimet, datat dhe lokacionet e konsultimeve etj. Nëse nuk jeni të sigurtë se në cilin nënkomitet të MSA-së bën pjesë çështja juaj, mos hezitoni të na kontaktoni.

Orari i konsultimeve me shoqërinë civile	
29 Nëntor 2016	Reforma e Administratës Publike - fokus të veçantë në racionalizimin e agjencive dhe organeve të të pavarura dhe mbështetjes buxhetore të sektorit të BE-së
30 Nëntor 2016	Inovacioni, shoqëria e informacionit dhe politika shoqërore
9 – 13 Janar 2017	Drejtësia, liria dhe siguria
16 – 20 Janar 2017	Tregu i brendshëm dhe konkurrenca, tregtia, industria, dogana dhe tatimet
6 – 10 Shkurt 2017	Transporti, mjedisi, energjia dhe zhvillimi rajonal
6 – 10 Mars 2017	Bujqësia dhe peshkataria
19 – 23 Maj 2017	Reforma e Administratës Publike
4 – 9 Shtator 2017	Çështjet ekonomike dhe financiare dhe statistikat

